

FJALA PËRSHËNDETËSE

---

**Joseph Limprecht**  
**Ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës**

**Guvernator Cani dhe të ftuar të nderuar,**

Ju faleminderit për ftesën që më keni bërë për të folur në konferencën tuaj për reformat vendore dhe integrimin europian. Jam i kënaqur që jam këtu për të ndihmuar në festimin e dhjetëvjetorit të Bankës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore. Dhe çfarë dekade që ka qenë.

Është e vështirë të imagjinohet një ambient ekonomik më sfidues se sa ky, dhe gjatë gjithë kësaj kohe Banka e Shqipërisë ka mbetur një institucion kyç në evolucionin e Shqipërisë nga një ekonomi e kontrolluar nga shteti në një ekonomi që lëviz nga tregu. Ky transformim ekonomik është themelor për integrimin e mëtejshëm të Shqipërisë në Europë dhe unë mendoj se banka ka shumë arsye për të qenë krenare për këtë.

Sot do të dëshiroja të flisja rreth progresit që Shqipëria ka bërë në përgatitjen për integrimin Euroatlantik dhe çfarë duhet të bëjë ky komb për të vazhduar këtë drejtim. Unë mendoj se fakti që Shqipëria është ftuar për të filluar negociatat e Stabilizim Asociimit me Bashkimin European, diku nga viti që po vjen është fakti më i qartë i këtij progresi.

Suksesi ose dështimi i kësaj përpjekjeje do të përcaktohet nga aftësia e Shqipërisë për të krijuar konditat që jo vetëm do të ruajnë stabilitetin mikroekonomik, por njëkohësisht do të mbështesin një ambient politik të qëndrueshëm dhe demokratik. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe partnerët tanë në Europë, gjithnjë e më shumë, po i bëjnë thirrje Shqipërisë për të kontribuar në stabilitetin rajonal duke ndërtuar stabilitetin e saj të brendshëm. Ne jemi të bindur se çështja më e rëndësishme në këtë përpjekje është zbatimi i ligjit.

#### **ZBATIMI I LIGJIT**

Ne në komunitetin ndërkombëtar shpesh përdorim termin “zbatimi i ligjit” kur diskutojmë reformat në drejtësi ose në rend, por çfarë do të thotë kjo në kontekstin e integritimit ekonomik dhe politik në Europë? Përgjigja bëhet e qartë në qoftë se ne e shikojmë rolin e zbatimit të ligjit në futjen e dëshirës tek qytetarët për të ecur sipas ligjit.

Njëra nga arsyt kryesore që Shqipëria po ndjek integrimin european është mundësia ekonomike që ai ofron, por shumë pak europeanë do të ishin të interesuar për të çuar më tej integrimin ekonomik dhe politik derisa shoqëria shqiptare të zbatojë ligjet e saj. Zbatimi është hapi i parë kritik në vendosjen e ligjit në çfarëdoq vendi, por një shoqëri e pjekur demokratike zhvillon një shpirt të tillë të zbatimit kur qytetarët kuptojnë të mirat e zbatimit të ligjit. Është ky shpirt i zbatimit të ligjit që do të inspirojë besimin dhe konfidencën në sistemet ekonomike, politike dhe sociale shqiptare, të nevojshme për vendin tuaj për të tërhequr investimet e vërteta të huaja dhe për të arritur integrimin e mëtejshëm european.

Në një nivel specifik, “zbatimi i ligjit” do të thotë që shumë kompani të huaja mund të marrin pjesë në tendera për projekte në Shqipëri duke ditur që kontraktori do të vlerësohet nëpërmjet një vendimi të drejtë dhe transparent. Do të thotë që këto kompani mund të sigurohen se një kontratë e nënshkruar në Shqipëri do të respektohet dhe se të gjitha mallrat e dërguar në Shqipëri do të

përballen me të njëjtat procedura doganore dhe taksa. Do të thotë që investitorët, që blejnë pasuri, duhet të jenë konfidentë që titulli do të jetë autentik dhe se mosmarrveshjet do të zgjidhen në një sistem gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm. Do të thotë që bizneset dhe qytetarët, gjithashtu, do të paguajnë taksat e tyre dhe faturat e energjisë elektrike. Ne jemi dëshmitarë të një lloj progresi në këtë drejtim.

## **DOGANAT**

Reforma doganore është një shembull në këtë drejtim. Me ndihmën e Komisionit European dhe USAID, qeveria ka rivendosur shërbimin doganor dhe mundësinë e saj për të mbledhur të ardhura. Shifrat flasin vetë: doganat mbledhin rreth 56 për qind të të ardhurave të përgjithshme të Shqipërisë. Të ardhurat doganore janë rritur me 5 për qind këtë vit, kurse taksat doganore janë ulur me 3 për qind duke treguar se Shqipëria po bën përpjekje për të plotësuar angazhimet e saj në Organizatën Botërore të Tregtisë. Përveç kësaj, të ardhurat nga taksa e importit janë dyfishuar qysh nga viti 1997. Korrupsioni dhe kontrabanda janë ulur në mënyrë të ndjeshme, siç vihet re edhe nga rritja e dukshme në volumin e mallrave të deklaruar të aksisës si për shembull nafta, kafeja, birra, cigaret dhe alkoli. Qeveria ka bërë përmirësime kyçe në forcimin e funksioneve të kontrollit të mbrendshëm dhe hetues dhe në zbatimin e një sistemi disiplinor për zyrtarët që thyejnë ligjin.

Gjithashtu, një sistem shpërblimi sipas arritjeve për inspektorët e doganave është adoptuar, i cili ofron iniciativa për ndershmëri dhe integritet. Tani doganat kanë krijuar një sistem parambërritës që do të ndihmojë për të ecur drejt integritit në Bashkimin European duke lehtësuar dërgesat nga vendet fqinje si Italia dhe Greqia. Së shpejti, ato do të fusin në punë një sistem kompjuterik dyrrugësh në të cilin oficerët doganorë mund të komunikojnë menjëherë me kolegët e tyre në këto vende për sasinë e vërtetë, llojin dhe vlerën e artikujve të transportuar.

## **MBLEDHJA E TAKSAVE**

Shqipëria, gjithashtu, ka treguar rezultate impresionuese në fushën e mbledhjes së taksave. Të ardhurat nga taksat, si përqindje e PBB janë rritur nga 5 për qind në vitin 1996 në më shumë se 7 për qind në treçerekun e parë të vitit 2001. Të ardhurat nga taksat e brendshme u përmirësuan si rezultat i një rritjeje në numrin e taksapaguesve të regjistruar, i reformës në TVSH dhe adoptimit të

një legjislacioni modern taksash, i cili ka rritur mundësitë e administratës tatimore për të luftuar evazionin fiskal.

Ndërsa rritja e të ardhurave ka qenë impresionuese, evazoni fiskal mbetet një problem i përhapur, veçanërisht në taksat mbi të ardhurat personale dhe TVSH. Më shumë mund të bëhet për të përmirësuar treguesit e mbledhjes së taksave.

#### **PAGESAT E FATURAVE TË ENERGJISË**

Gjatë vitit të kaluar, qeveria i ka kushtuar një vëmendje të veçantë reformimit të kompanisë shtetërore të energjisë KESH. Duke punuar me USAID dhe me donatorë të tjerë, qeveria ka zhvilluar një strategji të gjithanshme për energjinë që është hartuar për të përmirësuar arkëtimet dhe për të reduktuar vjedhjet, për të krijuar një agjenci rregulluese të pavarur, për të shtuar burimet e energjisë së vendit dhe për të liberalizuar çmimet e energjisë. Liberalizimi i fundit i çmimeve është një lëvizje pozitive për të përmirësuar situatën financiare të KESH, i cili do të tërheqë investime të reja të rëndësishme në gjenerimin e energjisë. Ishte një vendim i vështirë për të ngritur tarifën, por zhvillimi i mëtejshëm ekonomik nuk është i mundshëm pa aksione të vendosura. KESH ka bërë progres të rëndësishëm në reduktimin e humbjeve joteknike të energjisë dhe në përmbushjen e detyrave të tij për të përmirësuar mbledhjen e pagesave. KESH do të duhet të bëjë më shumë për të përmirësuar mbledhjen e parave nga individët, nga bizneset dhe, gjithashtu, edhe nga përdoruesit qeveritarë.

#### **PRIVATIZIMI**

Në tranzicionin e saj drejt një ekonomie të plotë tregu, qeveria mund të tregojë sukseset në privatizimin e bizneseve strategjike të vogla dhe të mesme. Shumë shembuj tregojnë progres drejt forcimit të perspektivave të vendit për rritje dhe për qëndrueshmëri më të madhe. Dy licencat e telefonisë celulare që janë dhënë; ofruesi i dytë u fut në treg këtë vit dhe rriti të ardhurat e qeverisë me rreth 38 milionë dollarë. Të dyja proceset e licencimit ishin transparente dhe të drejta dhe sollën shërbim më të mirë dhe çmime më të ulta për shqiptarët.

Koncensionet në minierat e kromit, të cilat janë ofruar për një periudhë 20-vjeçare, do të inicojnë një cikël pozitiv prodhimi dhe eksporti. Termat e ofruar do të rezultojnë në një investim total prej afër 35 milionë dollarësh. Investime të tjera në minierat e kromit dhe të bakrit shqiptar si dhe në uzinat e përpunimit të metaleve do të sjellin një investim tjetër, prej 25 milionë dollarësh në dekadën

tjetër, dhe do të krijojnë punësim të rëndësishëm për vendin. Privatizimet kanë influencuar në mënyrë të dukshme në investimet direkte të huaja, të cilat kanë vazhduar të përmirësojnë PBB-në dhe stabilitetin në vitet e fundit. Privatizimet e ardhshme në sektorët bankar dhe të telekomunikacioneve dhe në të tjerë sektorë, duhet të vazhdojnë këtë vazhdimësi pozitive.

#### **STABILITETI POLITIK**

Horizonti ekonomik për Shqipërinë është i ndritur, integrimi në strukturat euroatlantike është definitivisht rruga që të çon atje. SHBA dhe të tjerët në komunitetin ndërkombëtar janë këtu për të ndihmuar Shqipërinë në këtë integrim, por progresi i mëtejshëm varet nga aftësia e vendit për të ruajtur dhe për të zgjeruar stabilitetin që ka arritur deri më sot.

Shqipëria ka arritur shumë qysh nga anarkia e vitit 1997. Angazhimi i Shqipërisë në procesin e paqes në Maqedoninë fqinje, dhe mbështetja e saj ndaj përpjekjeve të komunitetit ndërkombëtar në Kosovë janë duartrokitur nga të gjithë ata që duan të shohin një të ardhme demokratike për Ballkanin. Por, është, gjithashtu, në interesin e Shqipërisë që të ketë bashkëpunim më të madh, mirëkuptim dhe angazhim ndaj proceseve demokratike si midis ashtu edhe brenda partive politike. Drejtuesit politikë duhet të marrin në konsideratë se çfarë do të thonë veprimet e tyre për interesat afatgjatë të të ardhmes së vendit- dhe jo të fokusohen në përfitimin e avantazheve ditore.

Partitë politike shqiptare duhet të punojnë së bashku për të zgjidhur problemet e vendit dhe të ecin përpara. Oponentët politikë duhet të jenë vetëm kaq- oponentë, jo armiq- dhe ka shumë çështje ndaj të cilave partizanllëku nuk duhet të luajë asnjë rol- lufta ndaj krimit të organizuar dhe trafikut, integrimi me strukturat transatlantike dhe lufta ndaj terrorizmit ndërkombëtar. Partitë duhet, në rradhë të parë, të demonstrojnë vullnetin politik dhe mençurinë për të punuar së bashku me idenë se politika nuk duhet shikuar si “fituesi i merr të gjitha”, por duhet të drejtohet nga përmbajtja dhe kompromisi. Partitë, që nuk marrin pjesë në proces vetëm dëmtojnë veten e tyre. Ato, gjithashtu, dëmtojnë edhe qytetarët që votuan për to—ata mbështetës meritojnë të kenë dikë në parlament që të përfaqësojë interesat e tyre.

#### **KONKLUZIONE**

Do të përfundoja duke thënë përsëri se Shqipëria ka bërë progres të dukshëm në rrugën drejt integritimit evropian. Anëtarësimi i

Shqipërisë në Organizatën Botërore të Tregtisë është një hap sinjifikativ në eliminimin e barrierave tregtare, në uljen e tarifave doganore dhe në rritjen e tregtisë ndërkombëtare. Nëpërmjet pranimit në Organizatën Botërore të Tregtisë ju keni filluar të harmonizoni legjislacionin me pjesën tjetër të ekonomisë botërore. Shqipëria është duke bërë progres edhe në negociimin e marrëveshjeve të tregtisë së lirë me vendet fqinje, duke filluar me Maqedoninë. Shqipëria duhet të forcojë tani institucionet e saj për t'u afruar më afër strukturave europiane. Ajo duhet të vazhdojë të ndërtojë institucione civile të qëndrueshme si për shembull, një sistem të drejtë gjyqësor të pastër nga korrupsioni dhe ryshfeti, një opozitë politike aktive dhe konstruktive dhe një ambient që nxit vendime ekonomike të bazuara mbi merita dhe tregun, dhe jo lidhje. Shqiptarët duhet të kenë dëshirën për të ndryshuar sjelljen e tyre vetiake dhe duhet të presin të njëjtën gjë nga drejtuesit e tyre dhe nga institucionet.

Rritja ekonomike e ardhshme e Shqipërisë dhe integriteti varen nga stabiliteti dhe zbatimi i ligjit. Ndërsa ju ecni përpara, ju mund të bazoheni në mbështetjen e Shteteve të Bashkuara, dhe në dëshirën e qëndrueshme të Shteteve të Bashkuara për të parë Shqipërinë të ecë në rrugën e integritit me institucionet europiane dhe euroatlantike.

Ju faleminderit.